

VENDIM
Nr. 766, datë 12.12.2022

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 528, DATË 24.6.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË ZONËN 1/1 TË RE PËR
ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE THUMANË, BASHKIA KRUIJË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, dhe të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 7, datë 6.1.2020, “Për kushtet dhe procedurat për shpronësimet, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, nr. 8, datë 6.1.2020, “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, të ndryshuar, e nr. 44, datë 22.1.2020, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Thumanë, Bashkia Krujë, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si njësi zbatuese”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 528, datë 24.6.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikat 3 dhe 4, shifra “... 20 932 039 (njëzet milionë e nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e tridhjetë e nëntë) lekë ...” zëvendësohet me “... 20 611 147 (njëzet milionë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e shtatë) lekë ...”.

b) Në tabelën bashkëlidhur vendimit bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. nëndarjet me numrat rendorë 18 dhe 22, që i përkasin pasurive me nr. 122/2, zonë kadastrale 3599, me vlerë kompensimi 3 978 000 (tre milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë dhe nr. 51/15, zona kadastrale 3599, shfuqizohen;

ii. të dhënat për pasuritë nr. 25/1, nr. 53/6, nr. 53/3 dhe nr. 53/1, që i përkasin, përkatësisht, nëndarjeve me numrat rendorë 6, 11, 14 dhe 16, ndryshohen sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi;

iii. shtohen nëndarjet me numrat rendorë 27, 28, 29 dhe 30, që i përkasin, përkatësisht, pasurive nr. 51/12, nr. 51/14, nr. 51/32 dhe nr. 51/33, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale të këtij vendimi, në vlerën prej 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Efekti financiar sipas pikës 1, të këtij vendimi, të zbritet nga fondi i akorduar për Bashkinë Krujë për këtë projekt, por të pashpenzuar dhe të mbartur në buxhetin e vitit 2022, dhe të kthehet në zërin “Fondi i rindërtimit”, të miratuar në buxhetin e vitit 2022.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Krujë dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTTIT PËR SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 528, DATË 24.6.2020, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË ZONËN 1/1 TË RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE THUMANË, BASHKIA KRUIJË"

Nr. rendor	Seksioni A që pasqyron pasurinë që ndryshohet në tabelën bashkëlidhur VKM nr. 528 datë 24.6.2020															
	Nr. rendor sipas VKM nr. 528 datë 24.6.2020	STATUSI JURIDIK					VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM, SIPAS LLOJIT TË PASURISË			Vegetacion	Dokumenti i pronësisë	Kompensim	VLERA TOTALE (lekë)	Shënime		
		PRIVAT			SHTET	TË DHËNAT (mbi pasurinë, sipas ASHK - Kruijë)			Shpronësim tokë "arë"						Çmimi lekë/m ²	Vlera /lekë
		Emri	Atësi	Mbiemër		ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë								
6	6	ZOJE AFRIM SARA	KURT XHEMALI XHEMALI	ZIRA ZIRA ZIRA		3599 THUMANË	25/1	ARË	4,100.0	4,100.00	442	1,812,200.0	√	1,812,200	Kjo pasuri është pasqyruar në tabelën e shpronësimit bashkëngjitur VKM nr. 528, datë 24.6.2020 me nr. rendor 6, me status juridik të pronësisë 'shtet', e llojit 'arë', me sipërfaqe 4100 m ² , me vlerë totale të shpronësimit 0 lekë. Pas daljes së VKM nr. 528 datë 24.6.2020, është regjistruar AMTP me datë 28.1.2021 dhe statusi juridik i kësaj pasurie është bërë 'privat'. Mbështetur në informacionin e dërguar nga ASHK Kruijë me shkresën nr. 1761/1 datë 24.9.2021, protokolluar në FSHZH me nr. 1768/2, datë 24.9.2021, kjo pasuri është e llojit 'arë' dhe është certifikuar me sipërfaqe 4100 m ² .	
11	11	SABA	ADEM	ZIRA		3599 THUMANË	53/6	ARË	1,750.00	1,750.00	442	773,500.0	√	773,500	Kjo pasuri është pasqyruar në tabelën e shpronësimit bashkëngjitur VKM nr. 528 datë 24.6.2020 me nr. rendor 11, me status juridik të pronësisë 'privat', e llojit 'arë', me sipërfaqe për shpronësim 2300 m ² dhe vlerë totale të shpronësimit 1,016,600 lekë. Mbështetur në informacionin e dërguar nga ASHK Kruijë me shkresën nr. 1761/1 datë 24.9.2021, protokolluar në FSHZH me nr. 1768/2, datë 24.9.2021, kjo pasuri është e llojit 'arë' dhe është certifikuar me sipërfaqe 1750 m ² .	
14	14	NAFIJE ALMA EGLANTINA TEUTA ALFRED SONILA KLEVIS	SALI ISMAIL ISMAIL ISMAIL ISMAIL ISMAIL	ZIRA ZIRA ZIRA ZIRA ZIRA ZIRA		3599 THUMANË	53/3	ARË	1,750.00	1,750.00	442	773,500.0	√	773,500	Kjo pasuri është pasqyruar në tabelën e shpronësimit bashkëngjitur VKM nr. 528, datë 24.6.2020 me nr. rendor 14, me status juridik të pronësisë 'privat', e llojit 'arë', me sipërfaqe për shpronësim 2040 m ² dhe vlerë totale të shpronësimit 901,680 lekë. Mbështetur në informacionin e dërguar nga ASHK Kruijë me shkresën nr. 1761/1 datë 24.9.2021, protokolluar në FSHZH me nr. 1768/2 datë 24.9.2021, kjo pasuri është e llojit 'arë' dhe është certifikuar me sipërfaqe 1750 m ² .	
16	16	FATIME FLORA GEZIM MIMOZA FATMIRA ARJANA GAZMIR	SALI SINAN SINAN SINAN SINAN SINAN SINAN	QIRA CARUNGU QIRA KURTI KURTI RRYCI QIRA		3599 THUMANË	53/1	ARË	5,350.00	5,350.00	442	2,364,700.0	√	2,364,700	Kjo pasuri është pasqyruar në tabelën e shpronësimit bashkëngjitur VKM nr. 528 datë 24.6.2020 me nr. rendor 16, me status juridik të pronësisë 'privat', e llojit 'arë', në pronësi të Mereme Tare Zira, me sipërfaqe për shpronësim 5620 m ² dhe vlerë totale të shpronësimit 2,484,040 lekë. Mbështetur në informacionin e dërguar nga ASHK Kruijë me shkresën nr. 1761/1 datë 24.9.2021, protokolluar në FSHZH me nr. 1768/2 datë 24.9.2021, kjo pasuri është e llojit 'arë' dhe është certifikuar me sipërfaqe 5350 m ² në pronësi të trashëgimtarëve ligjorë të Mereme Tare Zira.	
Seksioni B që pasqyron pasurinë që shtohet në tabelën bashkëlidhur VKM nr. 528, datë 24.6.2020																
27		ASTRIT	ADEM	ZIRA		3599 THUMANË	51/12	ARË	1,150	180.20	442	79,648.4	√	79,648.40	Nr. dok. 01007, data e regjistrimit 29.1.2019, tipi ND, mbi këtë ndodhet ndërtesa me nr. 51/30, vol. 9, f. 50.	

1. Çmimi sipas VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Z. K.	Çmimi (lek/m²)	
2182	truall	322
	arë	362
3599	truall	442
	arë	442